

SQARIM I DETAJUAR I DY DËSHMIVE TË ISLAMIT

SHEJKH SALIH EL-FEUZAN



**Sqarim rreth kuptimit, shtyllave, kushteve,
kërkesave, anuluesve të Dy Dëshmime dhe
kuptimet e gabuara në lidhje me to**

E para

Kuptimi i Dy Dëshmime

Kuptimi i dëshmisë *“la ilahe il-Allah,”* është që të besosh dhe të pranosh se adhurimin nuk e meriton askush përveç Allahut, t’i përmbahesh kësaj dhe të punosh me të. Fjala *“La ilahe”* mohon që adhurimin ta meritojë dikush tjetër veç Allahut, kushdo qoftë ai. Fjala *“il-Allah”* pohon se vetëm Allahu e meriton adhurimin. Ndërsa kuptimi i përgjithshëm i kësaj fjale është: **Nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut.**

Në gjuhën arabe është obligim që kallëzuesori i nënkuptuar i shkronjës “La” është “me të drejtë” dhe assesi nuk lejohet të thuhet se kallëzuesori i shkronjës “La” është “nuk ekziston” asnjë i adhuruar tjetër përveç Allahut, ngase kjo bie ndesh me realitetin, sepse të adhuruarit e tjerë përveç Allahut janë të shumtë.

Sipas kësaj i bie se adhurimi që bëhet për këta të adhuruar, është adhurim për Allahun, por kjo është nga të pavërtetat më të mëdha! Kjo është rruga e atyre që besojnë se gjithçka që ekziston është Allahu. Të këtillët janë njerëzit më qafira në sipërfaqen e tokës.

Kjo fjalë madhështore është komentuar me disa komente të pavërteta. Disa prej tyre janë:

1. **“Nuk ka të adhuruar tjetër veç Allahut.”** Ky komentim është i kotë, ngase kuptimi i tij është se çdo i adhuruar me të drejtë apo pa të drejtë, është Allahu, sikurse e cekëm më sipër.
2. **“Nuk ka krijues tjetër veç Allahut.”** Kjo është një pjesë e kuptimit të fjalës *“la ilahe il-Allah”*, mirëpo nuk është për qëllim vetëm kjo, sepse fjala “nuk ka

krijues tjetër përveç Allahut” nuk pohon tjetër veç Teuhidit Rububije, dhe ky lloji i teuhidit nuk mjafton. Ky është teuhidi që besonin mushrikët.

3. **“Nuk ka të drejtë të gjykojë askush tjetër përveç Allahut.”** Gjithashtu edhe kjo është një pjesë e kuptimit të fjalës *“la ilahe il-Allah”*, mirëpo nuk është për qëllim vetëm ky kuptim, ngase vetëm kjo nuk mjafton dhe nëse dikush do të pranonte se vetëm Allahu ka të drejtën e gjykimit, e nga ana tjetër, t’i lutej dikujt tjetër veç Allahut, apo t’i dedikonte atij ndonjë adhurim, një njeri i tillë nuk do të ishte muahid (monoteist).

Prandaj, të gjitha këto komentime janë të pavërteta apo të mangëta. Ne tërhoqëm vërejtjen rreth tyre sepse këto komentime gjenden nëpër disa libra që po qarkullojnë.

Komentimi i saktë i kësaj fjale **“la ilahe il-Allah”** sipas Selefëve dhe dijetarëve verifikues është që të thuhet: **Nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut, sikurse e cekëm.**

Ndërsa kuptimi i dëshmisë se Muhamedi është i dërguari i Allahut është: që ta pranojë nga ana e brendshme dhe ana e jashtme se ai është rob i Allahut dhe i dërguari i Tij të gjithë njerëzit; të punojë me atë që kërkon kjo fjalë duke iu bindur në atë që ai ka urdhëruar, t’i besojë për atë që ai ka lajmëruar, të largohet nga ajo për të cilën ai ka ndaluar dhe ka kërcënuar dhe të mos adhurojë Allahun me diçka tjetër veç asaj që ai ka ligjësuar.



E dyta

Shtyllat e këtyre Dy Dëshmime

Dëshmia “*La ilahe il Allah*” ka dy shtylla, të cilat janë: mohimi dhe pohimi.

Shtylla e parë: është mohimi, e cila është “*La ilahe – nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë,*” kjo asgjëson dhe zhvlerëson shirkun me të gjitha llojet e tij dhe e obligon kufrin (mohimin) e çdo gjëje që adhurohet përveç Allahut.

Shtylla e dytë: është pohimi, e ajo është “*il-Allah – përveç Allahut*”, kjo pohon se asgjë nuk e meriton adhurimin përveç Allahut dhe e bën obligim punën me të. Kuptimi i këtyre dy shtyllave ka ardhur në shumë ajete, siç është fjala e Allahut të Lartësuar:

﴿فَمَنْ يَكْفُرْ بِالطَّاغُوتِ وَيُؤْمِنِ بِاللَّهِ فَقَدِ اسْتَمْسَكَ بِالْعُرْوَةِ الْوُثْقَىٰ﴾

“Kush mohon tagutin dhe beson në Allahun, ai është kapur për lidhjen më të fortë.” el-Bekare, 256

Pra, fjala e Tij **“Kush mohon tagutin”** kjo është domethënia e shtyllës së parë “La ilahe”. Ndërsa fjala e Tij **“Dhe beson në Allahun”** kjo është domethënia e shtyllës së dytë “il-Allah”.

Gjithashtu edhe fjala e Tij ku tregon për Ibrahimin – alejhi selam:

﴿إِنِّي بَرَاءٌ مِّمَّا تَعْبُدُونَ ﴿٢٦﴾ إِلَّا الَّذِي فَطَرَنِي﴾

“Unë distancohem nga ata që ju i adhuroni, përveç Atij që më ka krijuar”. Ez-Zukhruf, 26-27

Fjala e Tij **“Unë distancohem nga ata që ju i adhuron”** ka kuptimin e mohimit që gjendet në shtyllën e parë, ndërsa fjala e tij **“Përveç Atij që më ka krijuar”** ka kuptimin e pohimit që gjendet në shtyllën e dytë.

Shtyllat e dëshmisë se Muhamedi është i dërguari i Allahut (Muhammedun resuluLlah)

Kjo dëshmi ka dy shtylla të cilat gjenden në fjalën tonë: **Rob dhe i dërguar i Tij**. Këto dy fjalë e mohojnë ekstremizmin (i cili është kalimi i kufijve) dhe neglizhencën ndaj tij – sal-la Allahu alejhi ue sel-lem. Ai është rob dhe i dërguari i Tij.

Ai është krijesa më e përsosur me këto dy cilësi fisnike. Kuptimi i fjalës “rob” këtu është: robi i Allahut, adhures. Që do të thotë: ai është njeri i krijuar prej asaj që janë krijuar edhe njerëzit tjerë; ai përjeton dhe përballet me atë që përjetojnë edhe njerëzit e tjerë, sikurse thotë Allahu i Lartësuar:

﴿قُلْ إِنَّمَا أَنَا بَشَرٌ مِّثْلُكُمْ﴾

“Thuaj: “Unë jam njeri sikur ju”. El-Kehf, 110

Ai - sal-la Allahu alejhi ue sel-lem - e përmbushi robërinë ndaj Allahut duke ia dhënë hakun tamam ashtu siç duhet dhe për këtë Allahu e lavdëroi atë. I Lartësuari thotë:

﴿أَلَيْسَ اللَّهُ بِكَافٍ عَبْدَهُ﴾

“A nuk i mjafton Allahu robit të Tij?!” ez-Zumer, 36

﴿الْحَمْدُ لِلَّهِ الَّذِي أَنْزَلَ عَلَى عَبْدِهِ الْكِتَابَ﴾

“Lavdërimi i takon Allahut i Cili ia zbriti librin robit të Vet”. El-Kehf,1

﴿سُبْحَانَ الَّذِي أَسْرَى بِعَبْدِهِ لَيْلًا مِّنَ الْمَسْجِدِ الْحَرَامِ﴾

“I pastër nga të metat është Ai i Cili ia mundësoi robët të Tij që të udhëtonte natën nga Mesxhidul Harami.” El-Isra, 1

Kuptimi i fjalës “*i dërguar*” d.m.th. ai që është dërguar për të gjithë njerëzimin që t’i thërras ata tek Allahu, duke i përgëzuar (për shpërblimin) dhe duke i kërcënuar (për dënimin).

Dëshmia për të përmban dy cilësi: mohim të ekstremizmit dhe neglizhencës kundrejt tij – sal-la Allahu alejhi ue sel-lem.

Sepse shumë prej atyre që pretendojnë se janë pjesë e umetit të tij, e kanë tepruar dhe i kanë kaluar kufijtë ndaj tij, saqë e kanë ngritur atë nga grada e të qenët rob i Allahut për në gradën e adhurimit krahas Allahut, duke i kërkuar ndihmë atij krahas Allahut në raste vështirësie , duke i kërkuar atij diçka për të cilën nuk ka fuqi për të askush tjetër veç Allahut, siç janë: plotësimi i nevojave të ndryshme dhe largimin e fatkeqësive nga ata.

Nga ana tjetër disa të tjerë, e mohojnë shpalljen që iu shpall atij apo neglizhojnë në pasimin e tij; u mbështeten mendimeve dhe fjalëve të cilat bien ndesh me atë që ka ardhur ai, duke i keqinterpretuar haberet dhe dispozitat e tij në përputhje me ëndjet e tyre.



E treta

Kushtet e Dy Dëshmime

Kushtet e dëshmisë “*La ilahe il Allah*”.

Dëshmia “*La ilahe il Allah*” ka shtatë kushte të domosdoshme dhe kjo dëshmi nuk i bën dobi atij që e thotë atë pa i përmbushur këto kushte. Kushtet e saj të përmbledhura janë:

- 1) Dituria, e cila refuzon injorancën.
- 2) Bindja, e cila refuzon dyshimin.
- 3) Pranimi, i cili refuzon kundërshtimin.
- 4) Nënshtrimi, i cili refuzon braktisjen.
- 5) Sinqeriteti, i cili refuzon shirkun.
- 6) Vërtetësia, e cila refuzon gënjeshtrenë.
- 7) Dashuria, e cila refuzon të kundërtën e saj e cila është urrejtja.

Shtjellimi i këtyre është siç vijon:

Kushti i parë: Dituria

Do të thotë që të ketë dije për kuptimin e saktë që synohet me këtë fjalë; çfarë pohon dhe çfarë mohon kjo fjalë, kuptim ky që hedh poshtë injorancën rreth saj, Allahu i lartësuar thotë:

﴿إِلَّا مَنْ شَهِدَ بِالْحَقِّ وَهُمْ يَعْلَمُونَ﴾

“Përveç atyre që dëshmojnë për të vërtetën duke e ditur atë.” ez-Zukhruf, 86

Fjala “**Dëshmojnë**” do të thotë se dëshmojnë për fjalën “*La ilahe il Allah*”,

Fjala “**duke e ditur**”, do të thotë me zemrat e tyre atë që dëshmojnë gjuhët e tyre. Nëse do ta shqiptonte këtë dëshmi duke mos ia ditur kuptimin, atëherë kjo nuk do i bënte dobi, sepse ai nuk ka besuar atë për të cilën argumenton kjo dëshmi.

❁ Kushti i dytë: Bindja

Që do të thotë: ai që e thotë atë dëshmi, të jetë plotësisht i bindur për atë që argumenton kjo dëshmi; nëse ai është i dyshimtë për atë që argumenton ajo, atëherë atij nuk i bën dobi, Allahu i Lartësuar thotë:

﴿إِنَّمَا الْمُؤْمِنُونَ الَّذِينَ آمَنُوا بِاللَّهِ وَرَسُولِهِ ثُمَّ لَمْ يَرْتَابُوا﴾

“Besimtarë janë vetëm ata që i besuan Allahut dhe të dërguarit të Tij, e pastaj nuk dyshuan”. El-Huxhurat, 15

Nëse ai është dyshues, atëherë është munafik.

I dërguari i Allahut – sal-la Allahu alejhi ue sel-lem - ka thënë:

“Këdo që takon pas këtij gardhi që dëshmon se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut, duke e patur zemrën e tij të bindur, përgëzoje me xhenet.”

Ai që nuk e ka zemrën e bindur për këtë dëshmi, nuk meriton të futet në xhenet.

❁ Kushti i tretë: Pranimi

Pranimi i asaj që kërkon kjo dëshmi: adhurimi i Allahut, të Vetëm dhe braktisjen e adhurimit të gjithçkaje veç Tij. Kush e thotë këtë fjalë pa e pranuar atë që kërkon ajo dhe pa iu përmbajtur asaj, ai është nga ata për të cilët Allahu thotë:

﴿إِنَّهُمْ كَانُوا إِذَا قِيلَ لَهُمْ لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ يَسْتَكْبِرُونَ﴾ ﴿٣٥﴾ وَيَقُولُونَ إِنَّا لَتَارْكَو آلِهَتِنَا لِشَاعِرٍ مَّجْنُونٍ﴾

“Kur atyre u thuhej: “Nuk ka të adhurar tjetër me të drejtë përveç Allahut!” Ata bëheshin arrogantë dhe thonin: “A t’i braktisim të adhurarit tanë për një poet të çmendur?!” Es-Safat,35-36

Kjo është gjendja e adhuruesve të varreve sot. Ata thonë: “La ilahe il Allah” mirëpo nuk e braktisin adhurimin e varreve. Pra, ata nuk e pranojnë kuptimin e fjalës “La ilahe il-Allah”.

Kushti i katërt: Nënshtrimi

Nënshtrimi ndaj asaj që argumenton kjo fjalë, i Lartësuari thotë:

﴿وَمَنْ يُسَلِّمْ وَجْهَهُ إِلَى اللَّهِ وَهُوَ مُحْسِنٌ فَقَدِ اسْتَمْسَكَ بِالْعُرْوَةِ الْوُثْقَى﴾

“Kush i nënshtrohet Allahut me singheritet, ai është kapur për lidhjen më të fortë”.
Lukman, 22

Lidhja më e fortë është dëshmia “La ilahe il Allah”, ndërsa kuptimi i fjalës “ia nënshton fytyrën e tij Allahut” d.m.th. i nënshtrohet Allahut duke qenë i singertë me Të.

Kushti i pestë: Vërtetësia

Që ta thotë këtë fjalë duke e besuar me zemër, sepse nëse ai e thotë me gjuhën pa e besuar me zemër, atëherë ai është munafik gënjeshtar. Allahu i Lartësuar thotë:

﴿وَمِنَ النَّاسِ مَنْ يَقُولُ آمَنَّا بِاللَّهِ وَالْيَوْمِ الْآخِرِ وَمَا هُمْ بِمُؤْمِنِينَ ۝٨ يُخَادِعُونَ اللَّهَ وَالَّذِينَ آمَنُوا وَمَا يُخْدَعُونَ إِلَّا أَنْفُسُهُمْ وَمَا يَشْعُرُونَ ۝٩﴾ فِي قُلُوبِهِمْ مَّرَضٌ فَزَادَهُمُ اللَّهُ مَرَضًا وَلَهُمْ عَذَابٌ أَلِيمٌ بِمَا كَانُوا يَكْذِبُونَ

“Ka njerëz që thonë: “Ne kemi besuar në Allahun dhe në Ditën e Fundit.” Po në realitet, ata nuk janë besimtarë. Ata përpiqen ta mashtrojnë Allahun dhe ata që

besuan, po në të vërtetë ata nuk mashtrojnë tjetër, pos vetvetes, por ata nuk e hetojnë. Në zemrat e tyre kanë sëmundje, e Allahu u shton sëmundje edhe më shumë, ata do të kenë denim të dhimbshëm për shkak se përgënjeshtroan.” El-Bekare, 8-10

❁ Kushti i gjashtë: Singheriteti

Singeriteti është pastrimi i veprave nga çdo njollë e shirkut; të mos synojë me thënien e kësaj dëshmie ndonjë të mirë të dunjasë, të mos synojë syfaqësinë apo famën, për shkak të hadithit të saktë që ka ardhur nga Itbani, i cili ka thënë:

“Vërtet që Allahu ia ka ndaluar zjarrit atë që thotë “La ilahe il Allah” duke synuar me të Fytyrën e Allahut”.

❁ Kushti i shtatë: Dashuria

Të ketë dashuri për këtë fjalë dhe për atë që argumenton kjo fjalë, si dhe të ketë dashuri për ata njerëz që e dëshmojnë këtë fjalë dhe punojnë me kërkesat e kësaj fjale.

I Lartësuari thotë:

﴿وَمِنَ النَّاسِ مَن يَتَّخِذُ مِن دُونِ اللَّهِ أَندَادًا يُحِبُّونَهُمْ كَحُبِّ اللَّهِ وَالَّذِينَ آمَنُوا أَشَدُّ حُبًّا لِلَّهِ﴾

“E nga njerëzit ka të tillë që në vend të Allahut besojnë idhujt, të cilët i duan (i madhërojnë) sikur Allahun, po dashuria e atyre që besuan Allahun është shumë më e fortë”. El-Bekare, 165

Pra, njerëzit që thonë “La ilahe il Allah”(duke i përmbushur kushtet e saj), e duan Allahun me dashuri të singertë, ndërsa njerëzit e shirkut, e duan Allahun mirëpo bashkë me Të duan edhe të tjerë, dhe mu kjo e kundërshton atë që kërkon fjala “La ilahe il Allah”.

Kushtet e dëshmisë **“Muhamedi është i dërguari i Allahut”** janë:

- 1) Pranimi i shpalljes që i erdhi atij dhe besimi në të me zemër.
- 2) Shqiptimi dhe pranimi i saj me gjuhë.
- 3) Pasimi i të Dërguarit duke punuar me të vërtetën që solli ai dhe duke i braktisur të pavërtetat nga të cilat ai i ka ndaluar .
- 4) T'i besosh atij për ato që ai ka lajmëruar, e që janë të fshehtat që kanë ndodhur në të kaluarën dhe që do të ndodhin në të ardhmen.
- 5) Ta duash atë më shumë se vetja jote, pasuria, fëmijët, prindërit dhe të gjithë njerëzit.
- 6) T'i japësh përparësi fjalës së tij ndaj fjalës së kujt do tjetër dhe të punosh me sunetin e tij.



E katërta

Kërkesat e Dy Dëshmime

Kërkesa e dëshmisë **“La ilahe il Allah ” është:** braktisja e adhurimit të çdo gjëje që adhurohet përveç Allahut, këtë e tregon mohimi që gjendet në fjalën “La ilahe” dhe të adhurohet Allahu, i Vetëm e i pa ortak, këtë e tregon pohimi kur ne themi “il-Allah”.

Shumë njerëz që e thonë këtë fjalë, e kundërshtojnë atë që kërkon ajo duke ia pohuar të drejtën e adhurimit që u është mohuar krijesave, varreve, vendeve të betejave, tagutëve, pemëve dhe gurëve.

Të tillët besojnë se teuhidi është bidat, dhe ia refuzojnë atij Teuhidin në të cilin ai thërret; e qortojnë atë që i përkushtohet me adhurim të singertë vetëm Allahut.

Ndërsa dëshmia se **“Muhammedun resulullah - Muhamedi është i dërguari i Allahut,”** kërkon që ti t’i bindesh atij, ta besosh atë, ta lësh atë që ai e ka ndaluar, të mjaftohesh duke punuar me sunetin e tij, të braktisësh çdo gjë veç sunetit, siç janë bidatet dhe shpikjet në fe, dhe t’i japësh përparësi fjalës së tij ndaj fjalës së çdokujt tjetër.



E pesta

Anuluesit e Dy Dëshmime

Këta anulues janë anuluesit e Islamit, sepse me shqiptimin e këtyre Dy Dëshmime njeriu hyn në Islam dhe shqiptimi i këtyre dyjave është pohim për domethëniet e tyre dhe kërkon që t'u përmbahesh kërkesave që kanë Dy Dëshmitë, siç janë kryerja e ritualeve të Islamit. Nëse tregohet i mangët dhe nuk i përmbahet kërkesave të Dy Dëshmime, ai e ka thyer marrëveshjen që mori përsipër kur i shqiptoi Dy Dëshmitë.

Anuluesit e islamit janë të shumtë. Dijetarët e fikhut kanë futur në librat e tyre një kapitull të veçantë dhe e quajten “Kapitulli i rides (daljes nga Islami)”. Mirëpo, anuluesit më kryesorë janë dhjetë të cilat i ka përmendur dijetari i Islamit, Muhamed bin Abdul-Uehab – Allahu e mëshiroftë - në fjalët e tij:

1) T'i përshkruash shok Allahut në adhurim (shirku), thotë Allahu i Lartësuar:

﴿إِنَّ اللَّهَ لَا يَغْفِرُ أَنْ يُشْرَكَ بِهِ وَيَغْفِرُ مَا دُونَ ذَلِكَ لِمَنْ يَشَاءُ﴾

“S'ka dyshim se Allahu nuk e falë mëkatin që t'i përshkruhet Atij shok në adhurim, e përpos këtij ia falë atij që do”. En-Nisa, 48

﴿إِنَّهُ مَنْ يُشْرِكْ بِاللَّهِ فَقَدْ حَرَّمَ اللَّهُ عَلَيْهِ الْجَنَّةَ وَمَأْوَاهُ النَّارُ وَمَا لِلظَّالِمِينَ مِنْ أَنْصَارٍ﴾

“Ai që i bën ortak Allahut, Allahu atij ia ka ndaluar (ia ka bërë haram) xhennetin dhe vendi i tij është zjarri. Për mizorët nuk ka ndihmues”. El-Maide, 72

Prej shirkut është edhe therja për dikë tjetër veç Allahut siç është therja për varret apo për xhinët.

2) Kush merr ndërmjetës midis tij dhe Allahut; i lut ata, u kërkon ndërmjetësim dhe mbështetet tek ata. I tilli del nga Islami me unanimitet.

- 3) Kush nuk i konsideron mushrikët (idhujtarët) qafira, apo dyshon në kufrin e tyre, apo e konsideron të saktë fenë e tyre, ai ka mohuar.
- 4) Kush beson se udhëzimi i dikujt tjetër është më i plotë dhe më i përsosur se udhëzimi i profetit – sal-la Allahu alejhi ue sel-lem, apo se gjykimi i dikujt tjetër është më i mirë se gjykimi i tij, sikur ata që preferojnë dhe u japin përparësi gjykimit të tagutëve më shumë se gjykimit të të dërguarit – sal-la Allahu alejhi ue sel-lem; ata që u japin më shumë përparësi ligjeve laike sesa Islamit.
- 5) Kush urren diçka që e ka sjellë i Dërguari – sal-la Allahu alejhi ue sel-lem - edhe nëse punon me të, i tilli ka dalë nga Islami.
- 6) Kush tallet me diçka të fesë së të Dërguarit – sal-la Allahu alejhi ue sel-lem - me shpërblimet apo ndëshkimet, ai ka dalë nga islami. Argument për këtë është fjala e të Lartësuarit:

﴿قُلْ أِبَاللّٰهِ وَآيَاتِهِ وَرَسُولِهِ كُنْتُمْ تَسْتَهْزِئُونَ﴾ ٦٥ ﴿لَا تَعْتَذِرُوا قَدْ كَفَرْتُمْ بَعْدَ إِيمَانِكُمْ﴾

“Thuaj: "A me Allahun, me ajetet dhe me të dërguarin e Tij u tallët? Mos u justifikoni, ju keni mohuar pasi që besuat”. Et-Teube, 65-66

- 7) Magjia, pjesë e të cilës janë: *sarfi* (ajo që bëhet për të larguar dashurinë midis burrit dhe gruas) dhe *atfi* (ajo që bëhet për ta shtuar dashuria midis burrit dhe gruas). Ai që e bën këtë apo që pajtohet me të, ka dalë prej Islamit. Argument për këtë është fjala e të Lartësuarit:

﴿وَمَا يُعَلِّمَانِ مِنْ أَحَدٍ حَتَّى يَقُولَا إِنَّمَا نَحْنُ فِتْنَةٌ فَلَا تَكْفُرْ﴾

“E ata të dy nuk i mësonin askujt (magjinë) para se t'i thonin: "Ne jemi vetëm sprovë, pra mos u bëj i pa fe!" el-Bekare, 102

- 8) Përkrahja dhe ndihma e idhujtarëve kundër Muslimanëve. Allahu i Lartësuar thotë:

﴿وَمَنْ يَتَوَلَّهُمْ مِّنْكُمْ فَإِنَّهُ مِنْهُمْ إِنَّ اللَّهَ لَا يَهْدِي الْقَوْمَ الظَّالِمِينَ﴾

“E kush prej jush i përkrah ata, ai është prej tyre. Vërtet Allahu nuk vë në rrugë të drejtë popullin zullumqar”. El-Maide, 51

9) Kush beson se i lejohet dikujt që të dalë jashtë Sheriatit të Muhamedit – sal-la Allahu alejhi ue sel-lem – sikurse i lejohej Hidrit që të dalë nga Sheriati i Musait –alejhi selam –, i tilli është kafir. Unë them: Siç besojnë sufistët ekstremistë se gjoja ata arrijnë një gradë që nuk kanë nevojë më për pasimin e pejgamberit – sal-la Allahu alejhi ue sel-lem.

10) Largimi dhe mospërfillja e fesë së Allahut; nuk e mëson Islamin dhe nuk punon me të. Argument për këtë është fjala e Allahut të Lartësuar:

﴿وَالَّذِينَ كَفَرُوا عَمَّا أُندِرُوا مُعْرِضُونَ﴾

“Ata që nuk besuan, nuk i vunë veshin asaj me çka u tërhiqet vërejtja”. El-Ahkaf, 3

﴿وَمَنْ أَظْلَمُ مِمَّنْ ذُكِّرَ بِآيَاتِ رَبِّهِ ثُمَّ أَعْرَضَ عَنْهَا ۚ إِنَّا مِنَ الْمُجْرِمِينَ مُنتَقِمُونَ﴾

“E kush është më zullumqar se ai që këshillohet me ajetet e Zotit të vet, e pastaj u kthen shpinën atyre? Ne me siguri do të hakmerremi kundër kriminelëve”. Es-Sexhde, 22

Shejkh Muhamed bin Abdul-Uehabi – Allahu e mëshiroftë – thotë: *“Nuk ka dallim në veprimin e këtyre anuluesve midis atij që i vepron ato me shaka, seriozitet apo nga frika, përveç atij që është i kërcënuar. Të gjithë këta janë nga anuluesit më të rrezikshëm dhe që ndodhin më së shumti. Prandaj, Muslimani duhet të ruhet prej tyre dhe të frikësohet për veten e tij se mos bie në to. Allahut i kërkojmë mbrojtje nga gjërat që shkaktojnë hidhërimin e Tij dhe që shkaktojnë ndëshkimin e Tij të dhimbshëm.”*

Burimi: *Akidetu Teuhid*, fq. 50-61



Përktheu: Muhamed Kallashi

3 Muharrem 1442 h.

22 Gusht 2020

Fier